



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2021:174662

Datë: 24.06.2024

Numri i dokumentit: 05850984

P.nr.97/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Leposaviq - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri Islami, me bashkëpunëtoren profesionale Kaltrina Sfarqa, në lëndën penale ndaj të pandehurit G.D, për shkak të veprës penale: Kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të Kodit (Nr. 06/L-074) Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas Aktakuzës PP/II.nr.725/2021, të datës 05.08.2021 të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 18.06.2024, në mungesë të Prokurorit të Shtetit Sebahate Sinani dhe të pandehurit G.D, me datë 18.06.2024 shpalli publikisht, ndërsa më datë 24.06.2024, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

G.D, me nofkën “.....”, nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur me datë në Kumanovë, me adresë të vendabnimit në rrugën “.....”, në Leposaviq, me numër personal të identifikimit, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Se ekziston dyshimi i bazuar se ka dijeni për veprimet dhe pasojat e tij, të njëjtën ditë me datë 06.01.2021 në ora 19:55, në Leposaviq, në ambientet e stacionit policor, ka kanosur rëndë B.P nga Leposaviqi me fjalë dhe më pas me gjeste se do të i bënte keq me qëllim që ta trembte apo

ta shqetësonte, ashtu që në momentin kur i është përgjigjur thirrjes së policisë për të proceduar rastin e aksidentit rrugorë që kishte me vajzën e viktimës B.P, J, nën efektin e alkoolit i cili e ka poseduar në masën 0.88%, nën zë, i pa provokuar, duke gjestikulluar me trup, ka lëvizur në drejtim të viktimës duke shprehur kërcënimin me fjalët “kush je ti këtu, je gjyshe, çfarë bënë, mendo se kam frikë prej teje, ti e din që unë mund të merrem me ty fizikisht, nëse mundesh me të tjerët, sigurisht që nuk mundesh, më vidhos, ti e din që në një moment do të hakmerrem dhe mund të të rah”, ku është penguar të sulmoj fizikisht të dëmtuarin nga policët e pranishëm S.R dhe M.P,

- Me këtë ka kryer veprën penale: Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 43, 69, 70, dhe nenit 181 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 358, 364, 449, 462 të KPP-së, i:

SHQIPTON

-DËNIM ME GJOBË në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilin dënim - gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veproj në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t’ia zëvendësoj në dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

-OBLIGOHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (20) euro, po ashtu edhe në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

-Pala e dëmtuar B.P, për kërkesën pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko - civil.

A r s y e t i m i

Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.725/2021, të datës 05.08.2021, ndaj të pandehurit G.D, për shkak të veprës penale: Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Me datë 18.06.2024, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e palëve, prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Sebahate Sinani dhe të pandehurit G.D.

I pandehuri, në seancën e shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata, me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale, është deklaruar dhe ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së prokurorisë. Ka kërkuar falje për rastin e ndodhur, duke deklaruar se rasti ka ndodhur rastësisht, me të dëmtuarin janë pajtuar dhe kanë raporte shumë të mira, gjykatës i propozoi që të i shqiptohet një dënim me gjobë.

Gjykata ka marrë mendimin nga prokurori i shtetit mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri G.D.

Prokurori i shtetit Sebahate Sinani, i propozoi gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së dhe ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Lidhur me rrethanat e matjes së dënimit, gjykatës i propozoi që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese të merret shkalla e përgjegjësisë penale, mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, ashtu që të pandehurit të i shqiptohet një sanksion penale i paraparë me KPRK i cili do të i përgjigjet rrethanave të kryerjes së veprës penale dhe me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjetjet e Gjykatës:

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i pandehuri G.D, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë për të pandehurin. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021/SE/002 i datës 06.01.2021; Shënimi zyrtar i datës 06.01.2021; Raportet policor me numër të rastit 2021/SE/002 të datës 06.01.2021; Deklarata e të dëmtuarit e datës 06.01.2021; Procesverbali mbi intervistimin e të pandehurit pranë Inspektoratit Policor të Kosovës i datës 26.03.2021 dhe 30.03.2021; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarëve S.R dhe M.P të datës 02.04.2021; Foto albumi nga shkresat e lëndës; Procesverbali mbi ekzaminimin e pranisë së alkoolit në organizëm i datës 06.01.2021; si dhe shkresat e tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimit të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale: Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata ia kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri G.D është i përgjegjshëm dhe përgjegjës për veprën penale për të cilat akuzohet: Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin G.D, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese, gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, i pandehuri ishte i përgjegjshëm dhe

përgjegjës për këtë vepër penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, veprën penale e kishte kryer me dashje, kontributin esencial të pandehurit të kjo vepër penale.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira, kërkim faljen e shprehur nga i pandehuri në seancë gjyqësore, faktin se më të dëmtuarin tanimë kanë raporte shumë të mira, ka bashkëpunuar plotësisht me organet e rendit dhe drejtësisë që nga fillimi i procedurës kundër tij, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimiti i fajësisë në tërësi për veprën penale që në hapje të shqyrtimit fillestar të çështjes.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me gjobë, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par.1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit dhe të dëmtuarin e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko – civil në kuptim të nenit 462 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 449, 462 të KPPK-ës nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Leposaviq
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.97/2021, datë 24.06.2024

Bashkëpunëtore Profesionale:
Kaltrina Sfarqa

Gjyqtarja e vetme gjykuese:
Qëndresa Tahiri Islami

KËSHILË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.